| Nr. Rendor | Data e regjistrimit | Objekti | Data e kthimit të përgjigjes | Përmbajtja e përgjigjes | Mënyra e përfundimit të kërkesës (E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar) | Tarifa e shërbimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Periudha Janar 2026** | | | | | | |
| 1 | 08.01. 2026 | Kërkohet informacion mbi vlerësimet e punës | 20.01.2026 | Përshëndetje z. Ç.,<br>Në përgjigje të kërkesës suaj përcjellë nëpërmjet postës elektronike më datë 8.1.2026, me anë të së cilës, në bazë të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, kërkoni informacion lidhur me formularët dhe rezultatet e vlerësimeve tuaja të punës, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit Evropian, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Departamenti i Administratës Publike ju informon për sa më poshtë vijon:<br>Nga të dhënat e gjeneruara nga Regjistri Qendror i Personelit (RQP/HRMIS) rezulton se, lidhur me vlerësimin e rezultateve tuaja të punës, në sistem është pasqyruar informacioni sa më poshtë vijon:<br>1.1.2017 - 7.7.2017 shumë mirë<br>1.1.2018 - 10.7.2018 shumë mirë<br>1.1.2019 - 4.7.2019 shumë mirë<br>1.7.2019 - 31.12.2019 shumë mirë<br>Për periudhat e vlerësimit të lartpërmendura, të dhënat janë hedhur manualisht nga përdoruesi i RQP-së së institucionit punëdhënës, ndërkohë nuk rezultojnë të ngarkuar në sistem formularët respektivë të vlerësimit. | E plotë | Nuk ka |